

VENDIM
Nr. 174, datë 7.7.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
OST SHA PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETVE TË INVESTIMIT TË
KRYER NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SUPPLY AND INSTALATION OF
TRANSMISSION METER/DATA CENTER” NGA OST SHA TEK OSHEE GROUP SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pika 1.3 e “Licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/6 prot., datë 4.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “*Supply and Instalation of Transmission Meter/data center*” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Trasmetimit (OST) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 944 prot., datë 20.6.2022, ka paraqitur kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “*Supply and Instalation of Transmission Meter/data center*” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë, në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni për qëllim të këtij aplikimi është plotësuar, si më poshtë:

Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, pikat 3, 4 dhe 6.

Shoqëria OST sh.a. duhet të sjellë listën e detajuar të aseteve, e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së lidhur me OSHEE sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “*Supply and Instalation of Transmission Meter/data center*” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti